



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:199157  
Datë: 28.03.2024  
Numri i dokumentit: 05515364

**CA.nr.3854/24**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Kujtim Pasuli dhe Besnik Bislimaj, antarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit–propozuesit të sigurimit H.H., nga Obiliqi, të cilin sipas autorizimit i përfaqëson V.B. , avokat në P, kundër të paditurit–kundërshtarit të sigurimit F. H., nga O., rruga xxxx, me objekt kontesti, vërtetimi i së drejtës së pronësisë mbi bazën e trashëgimisë, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga propozuesi i masës së sigurimit H. H., ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat V. B. nga Prishtina, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.35/17, i dt.02.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt **27.03.2024**, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR** ankesa e propozuesit të masës së sigurimit-paditësit H.H. nga O., ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat V. B. nga P., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.35/17, i datës 02.11.2023 **VËRTETOHET.**

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar, me numër C.nr.35/17, të dt:02.11.2023, duke vepruar sipas propozimit për caktim të masës së sigurimit, ka vendosë si në vijim:

**REFUZOHET** i pabazuar propozimi i paditësit–propozuesit H.H., nga Obiliqi, për caktimin e masës së sigurimit, përmes së cilës ka kërkuar që të Caktohet masa e sigurimit ashtu që t'i ndalohe të paditurit – kundërshtarit të sigurimit F. H., nga Obiliqi, çdo ndryshim i gjendjes faktike në pronën e paluajtshme e cila evidentohet si njësi kadastrale nr.754-1, Zona Kadastrale

Obiliq, vendi i quajtur “Novi Obiliq”, derisa të vendosët lidhur me kërkesëpadinë e paditësit për ndarjen e trashëgimisë.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë ka ushtruar propozuesi i masës së sigurimit-paditësi H. H., përmes të autorizuarit të tij, avokat Valdrin Behrami nga Prishtina, shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke e kundërshtuar në tërësi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e propozuesit të masës së sigurimit, dhe aktvendimi i ankimuar të priset dhe çështja të kthehet në ri vendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë, nuk është ushtruar nga kundërshtari i masës së sigurimit.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të ankesës, analizimit dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) të LPK-së, konstatoi se:

**Ankesa e e propozuesit të masës së sigurimit-paditësit H. H. nga O., ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat Valdrin Behrami nga Prishtina, rezulton e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se propozuesi i masës së sigurimit H. H. nga O., fillimisht me datë 04.01.2017, ka ushtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi bazën e trashëgimisë kundër të paditurit F. H. nga Obiliq ka ushtruar propozim për caktimin e masës së sigurimit, ndërsa me datën 09.09.2022, përmes të autorizuarit të tij, avokat V. B. nga Prishtina ka ushtruar edhe propozim për caktimin e masës së sigurimit, përmes të cilit ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit me të cilin i ndalohet kundërshtarit të sigurimit F. H., ndryshimi i gjendjes faktike në pronën e paluajtshme e cila gjendet në Obiliq, ngastrat kadastrale me nr.754/0, 754/1, 754/2, deri në vendosjen meritorë nga gjykata lidhur me padinë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë

Kundërshtari i masës së sigurimit edhe pse nga gjykata iu është dërguar propozimi së bashku më provat për dhënien e përgjigjes në propozim, të njëjtin brenda afatit ligjor prej 7 ditësh nuk është përgjigjur dhe po ashtu përkundër ftesës me rregull nga gjykata, i njëjti nuk ka prezantuar në seancën gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit.

Gjykata e shkallës së parë, pas zhvillimit të procedurës lidhur me caktimin e masës së sigurimit, nxjerrjes dhe administrimit të provave, me aktvendimin e ankimuar ka vendosur për refuzimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të tij.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, në pjesën arsyetuese të aktvendimit të ankimuar, ka theksuar se gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit i vlerësoj pretendimet e palëve ndërgjyqëse të dhëna në parashtresat e dorëzuara dhe në seancën e dëgjimit si dhe provat

e deponuara në shkresat e lëndës, dhe ka gjetur së propozuesit e sigurimit deri në këtë fazë të procedurës nuk e kanë bërë të besueshëm ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së tyre.

Me nenin 297 të LPK-së, është paraparë se *“Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*. Me nenin 300 të LPK-së është paraparë se për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurimit. Ndërsa me nenin 304.3 të LPK-së, është paraparë se *“Propozuesi në propozimin e tij duhet t'i tregoj edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”, si dhe që këto “mjete provuese t'ia bashkëngjisë propozimit”*.

Sipas dispozitës së lartcekur për caktimin e masës së sigurimit duhet që në mënyrë kumulative të plotësohen dy kushte që propozuesit e sigurimit të bënë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës.

Meqenëse në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese fakti së propozuesi i sigurimit dhe kundërshtari i sigurimit janë vëllezër dhe të njëjtit janë fëmijët e të ndjerit A. H., i cili ka vdekur me datë 21.09.1996, në emër të secilit është e evidentuar njësia kadastrale nr.754-1, ndaj të cilës propozuesi kërkon që të caktohet masa e sigurimit, gjykata vlerëson së në këtë rast propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive, pasi që konsiderohet së i njëjti është trashëgimtar ligjor i të ndjerit A. H..

Mirëpo, edhe përkundër faktit së propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshëm ekzistimin e të drejtës subjektive, i njëjtit nuk e ka provuar ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, andaj në mungesë të plotësimi të këtij kushti nuk mund të caktohet masa e sigurimit. Kjo pasi që përmes ekspertizës së gjeodezisë të datës 05.07.2023, të cilën e ka përpiluar eksperti i gjeodezisë Qemajl Hoda, është vërtetuar së ngastra kontestuese nr.754-1, në sipërfaqe prej S=3294m<sup>2</sup>, e cila gjendet ne vendin e quajtur “Novi Obiliq”, evidentohet në posedim individual të A.n (H.) H. Ndërsa në seancën e dëgjimit eksperti i gjeodezisë ka theksuar se pas shikimit në vendin e ngjarjes së bashku me gjykatën ka konstatuar se gjendja faktike e ngastrës nr.754-1, ishte e pandryshuar nga raporti i dhënë me shkrim me datë 29.11.2016, e cila ekspertizë ishte nxjerrë në rastin për pengim posedim sipas lëndës C.nr.3230/15. Gjykata gjeti së me aktvendimin C.nr.3230/15, të datës 07.04.2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, e ka refuzuar kërkesëpadinë e këtu propozuesit në çështjen për pengim posedim, dhe ky aktvendim ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin Ac.nr. 2865/17, të datës 06.12.2017. Në kontestin për pengim posedim këtu propozuesi kishte pretenduar së nga kundërshtari i sigurimi është penguar në atë mënyrë që në pjesën e palujtshmërisë së paditësit në ngastrën kadastrale nr.754/1, e ka ndërtuar shtëpinë dhe e ka vendosur hyrjen dhe shkallët e shtëpisë, çeshmën me gypin dhe orën e ujit, zhavorrin, bllokat dhe gjësendet tjera në pjesën e parcelës së paditësit të cilën e ka pasur në posedim të fundit faktik, si dhe duke e penguar paditësin në posedimin e qetë dhe faktik të një pjese të palujtshmërisë të kësaj ngastre si rrugë e shtruar me gurë dhe dyer metalike për

qasje në palujtshmërin, garazhën, parcelën dhe objektin e tij afarist si dhe për dalje në rrugë nga shtëpia e tij dhe anasjelltas.

Gjykata me rastin e dajës në vend shiqim me ekspertin e gjeodezisë ka konstatuar së në ngastrën kontestuese nr.754-1, ekziston e ndërtuar shtëpia e paditësit-propozuesit me etazhitet P+1, dhe objekti i ndërtuar nga i padituri-kundërshtari i sigurimit me etazhitet P+1, dhe sipas gjetjes faktike propozuesi pretendon së rruga për dalje në rrugën kryesore nëpër ngastrën 754-1, dhe 7543-3, ZK Obiliq, është e tij, ndërsa kundërshtari i sigurimit nuk ka të drejtë të qaset nëpër këtë rrugë dhe të bëjë ndryshime në rrugë qoftë duke e shtruar me zhavor apo në ndonjë mënyrë tjetër pasi që i njëjti e ka rrugën në anën veriore e cila është e shtruar me kupëza të betonit dhe e cila është e lidhur me rrugën kryesore poshtë dhe lartë.

Sipas dispozitave të sipërcituara, caktimi i masës së sigurimit ka për qëllim sigurimin e kërkesës kryesore në rastet kur ekziston rreziku së pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës. Në rastin konkret propozuesi i sigurimit përmes kërkesëpadisë përveç ngastrave tjera ka kërkuar edhe vërtetimin e pronësisë mbi bazën e trashëgimisë në ngastrën nr.754-1, në të cilën ngastër është vërtetuar së edhe kundërshtari i sigurimit e ka të ndërtuar shtëpinë, ndërsa caktimin e masës së sigurimit e kërkon me arsyetimin së kundërshtarët e sigurimit mund ta ndryshojë gjendjen ekzistuese sidomos me ndërtim. Gjykata gjeti së propozuesi i sigurimit nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e rrezikut së pa caktimin e masës së sigurimit të njëjtit do t'i pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesës, ngase është vërtetuar së në ngastrën kontestuese nr.754-1, si propozuesi ashtu edhe kundërshtari i sigurimit kanë të ndërtuar shtëpitë-objektet me etazhitet P+1, të cilat kanë qenë të ndërtuar para se të paraqitet në gjykatë propozimi për caktimin e masës së sigurimit, dhe është vërtetuar së kjo ngastër evidentohet në emër të prindit të tyre tani i ndjerë. Sa i përket ndryshimit të gjendjes faktike, përmes këqyrjes në vend dhe në bazë të konstatimit të ekspertit të gjeodezisë, është vërtetuar se në ngastrën në fjalë nuk ka pasur asnjë ndryshim të gjendjes faktike që nga koha kur është përpiluar ekspertiza e gjeodezisë e datë 29.11.2016, e cila provë ishte marrë në kontestin për pengim posedim që ishte zhvilluar në mes të këtu palëve ndërgjyqëse. Andaj, duke qenë se që nga ajo kohë kundërshtari i sigurimit nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndryshimit të gjendjes faktike dhe rrezikimit të së drejtës së propozuesit, gjykata vlerëson së në rastin konkret nuk është plotësuar kushti i rrezikshmërisë, dhe në mungesë të plotësimit të këtij kushti nuk mund të caktohet masa e sigurimit.

Gjykata gjeti së pas mbajtjes së seancës së dëgjimit të datës 18.10.2023, ku gjykata kishte konstatuar të përfunduar seancën sa i përket caktimit të masës së sigurimit, i autorizuari i propozuesit përmes parashtresës së datës 23.10.2023, ka parashtruar së kundërshtari i sigurimit në vazhdimësi ka vazhduar pengimin ndaj propozuesit ku së fundi në rrugën e propozuesit ka vendosur “blloka” ndërtimor si dhe ka bërë mbjelljen e disa “luleve” dhe e ka bllokuar rrugën propozuesit, duke ia bashkangjitur parashtresës disa fotografi. Duke qenë se këto fotografi në cilësi të provës materiale janë dorëzuar pas përfundimit të seancës së dëgjimit në të cilën seancë i autorizuari i propozuesit kishte deklaruar së nuk ka propozime tjera, gjykata me rastin e vendosjes për propozimin për caktimin e masës së sigurimit të njëjtat nuk i mori për bazë, pasi që për to nuk i është dhënë mundësia kundërshtarit të sigurimit që të deklarohet, dhe përveç kësaj nuk dihet së kur janë bërë këto fotografi pasi që nuk kanë datë dhe nuk dihet së kush i ka vendosur paletat me blloka dhe për çfarë qëllimi. Për me tepër, siç është cekur me sipër çështja kryesore sipas kërkesëpadisë ka për objekt kontesti vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe jo pengim posedimin, dhe bazuar në shkresat e lëndës gjykata ka gjetur së propozuesit të sigurimit nuk i rrezikohet kërkesa e tij, duke qenë se ngastra kontestuese evidentohet në emër të prindit të tyre të ndjerë, dhe nuk kishte ndryshim të gjendjes faktike nga ana e kundërshtarit të sigurimit e cila

do t'ia pamundësonte propozuesit realizimin e të drejtës së tij, e që në këtë rast është vërtetimi i të drejtës së pronësisë mbi bazën e trashëgimisë.

Gjykata vë në dukje se vendosja për masën e sigurimit të kërkesëpadisë, nuk ka të bëjë me vendosjen përfundimtare të çështjes kontestuese, dhe nuk është bërë vlerësimi i fakteve në atë mënyrë që në ndonjë mënyrë mund të aludonte në mënyrën e vendosjes përfundimtare, porse në këtë fazë gjykata mbështet në dy kushtet e vëna nga neni 297 i LPK-së, që ka të bëjë me bërjen të besueshme të së drejtës subjektive (297.1 pika a), dhe kushti tjetër që ka të bëjë me rrezikun se pa caktimin e masës së tillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte e dukshëm realizimin e kërkesës (neni 297.1 pika b).

Nga sa u tha më lartë, gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet e parapara me dispozita ligjore për caktimin e masës së sigurimit, andaj konform dispozitave ligjore nga neni 387.1 pika (1) lidhur me nenin 142.5 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje, vlerëson se përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe se aktvendimi i atakuar nuk është i shoqëruar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, i njëjti aktvendim nuk është i shoqëruar as me shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuese nga neni 182, par.2, pika (n), në lidhje me nenin 160, par.4 dhe 5 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht në rastin konkret.

Gjykata e Apelit, nga ekzaminimi i aktvendimit të goditur me ankesë, gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi i masës së sigurimit këtu paditësi me padinë e iniciuar në këtë çështje kontestimore ka kërkuar nga kundërshtari i masës së sigurimit që të mos ndryshoj gjendjen faktike në ngastrën lëndore 754-1 ZK Obiliq, në vendin e quajtur "Nvi Obiliq", deri në vendosje të kërkesëpadisë së paditësit, dhe se gjykata e shkallës së parë, ashtu siç ka konstatuar në këtë çështje juridike, në rastin konkret edhe pse propozuesi i masës e ka bërë të besueshme të drejtën e tij subjektive, ku së bashku me kundërshtarin e masës së sigurimit F.H., janë trashëgimtarë ligjor të rendit të parë të këtu të ndjerit A. H. ish nga O., dhe se sipas konstatimeve të gjendjes faktike në terren të bërë nga eksperti gjeodet vërtetohet se edhe propozuesi i masës dhe kundërshtari i masës së sigurimit kanë të ndërtuara shtëpitë e tyre me specifika si në ekspertizë, dhe këto shtëpi të ndërtuara janë para se propozuesi i masës të inicioj procedurë kontestimore dhe paraqesë propozim për caktimin e masës së sigurimit, dhe se nga gjendja e vërtetuar faktike nga gjykata e shkallës së parë të cilën gjendje e pranon në tërësi edhe gjykata e shkallës së dytë, vërtetohet se në rastin konkret edhe pse kushti i parë nga neni 297 pika a) të LPK-së, përmbushet, megjithatë kushti i dytë i kërkuar dhe atë vërtetimi i ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të vështirësohet apo pamundësohet realizimi i të drejtës subjektive të propozuesit, këtu nuk është vërtetuar sepse kundërshtari i masës së sigurimit me asnjë provë nuk vërtetohet se ka marrë veprime në drejtim të ndryshimit të gjendjes faktike të ngastrës lëndore objekt i kontestit, dhe nisur nga ky vërtetim i faktit i njëjti edhe nuk e ka ndryshuar gjendjen faktike të ngastrës lëndore, prandaj, në kuptim të nenit 297 pika a) dhe b) në lidhje me nenin 300 par.1 dhe 3 të LPK-së, në rastin konkret propozuesi i masës së sigurimit ka dështuar të argumentoj para gjykatës plotësimin e dy kushteve ligjore për caktimin e masës së sigurimit në ngastrën lëndore 754-1, e cila sipas padisë së paditësit është objekt kontesti dhe e njëjta derivon nga parardhësi i ndërgjyqësve babai i tyre këtu i ndjeri A. H..

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes lidhur me mjetin juridik, shqyrtoi edhe provat e prezentuara nga parashtruesi i ankesës H. H., përmes të autorizuarit të tij, avokat V. B. nga P., dhe atë fotot e prezantura ku shihen vendosja e disa paletave me blloka, mirëpo, të njëjtat foto nuk përmbajnë datë dhe nuk mund të vërtetohet se kur janë bërë, e gjithashtu a lidhen me parcelën lëndore 754-1, ngase, në fazën e mjetit juridik palët mund të parashtrojnë prova të reja vetëm nëse të njëjtat nuk kanë mund ti paraqesin në procedurën e gjykatës së shkallës së parë pa fajin dhe dijeninë e tyre, apo provat e reja kanë ardhë pas nxjerrjes së aktvendimit të ankimuar, referuar nenit 180 par.1 dhe 2 të LPK-së, e që në rastin konkret provat e prezentuara nga ushtruesi i ankesës nuk i plotësojnë kriteret e kërkurara për marrje për bazë dhe shqyrtim të tyre nga gjykata e shkallës së dytë, konform dispozitave të cekura më lartë, andaj, edhe të njëjtat kjo gjykatë nuk i morri për bazë.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të ushtruesit të ankesës, mirëpo, të njëjtat më tepër rezultuan se kishin të bëjnë me dështimin e gjykatës së shkallës së parë që të arsyetoj vendimmarrjen si në dispozitiv të aktvendimit të goditur me ankesë dhe referim në detyrimin e gjykatave të rregullta që të arsyetojnë vendimet e tyre sipas përfundimeve kushtetuese që janë dhënë nga Gjykata Kushtetuese, e të cilat gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar mjaftueshëm faktet që kanë rezultuar në dështimin e propozuesit për të bërë të besueshëm propozimin për caktimin e masës së sigurimit në rastin konkret, andaj, pretendimet në fjalë nuk është e nevojshme të arsyetohen më hollësisht.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e arsyeve të lartcekura, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209, pika (b) të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**CA.nr.3285/2024, dt: 27.03.2024**

**Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari**  
**Besnik Feka**